

V E N D I M  
Nr.425, datë 20.5.1996

PER MIRATIMIN E RREGULLORES "PER PRODHIMIN, INSTALIMIN DHE  
SHFRYTEZIMIN E REZERVUAREVE TE GAZIT TE LENGZUAR TE NAFTES"

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe  
Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të miratojë rregulloren për prodhimin, instalimin dhe  
shfrytëzimin e rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës", që  
i bashkangjitet këtij vendimi.

2. Në nenin 23 të urdhëresës së Këshillit të Ministrave  
nr.11, datë 21.11.1977, ndryshuar me vendimin nr.142, datë  
4.5.1985, nga pajisjet nën presion, përjashtohen rezervuarët e  
gazit të lëngëzuar të naftës dhe tubacionet e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE  
Aleksandër Mexsi